



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 445 Prot.

Tiranë, më 28.03 2019

VENDIM Nr. 71 datë 18.03.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, datë 18.03.2019, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Babunjë" 2019*, drejtuar nga Prof.Dr.Bashkim Lahi (IA) dhe Prof.Asoc.Eduard Shehi (IA) dhe Universiteti Humboldt, Berlin, Gjermani, Instituti Arkeologjik Austriak si dhe Akademia e shkencave në Austri me mbështetjen e Institutit Arkeologjik Gjerman (DAI), Departamenti, Romë, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Babunjë" 2019*, drejtuar nga Prof.Dr.Bashkim Lahi (IA) dhe Prof.Asoc.Eduard Shehi (IA) dhe Universiteti Humboldt, Berlin, Gjermani, Instituti Arkeologjik Austriak si dhe Akademia e shkencave në Austri me mbështetjen e Institutit Arkeologjik Gjerman (DAI), Departamenti, Romë, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

Vazhdimi i gërmimeve të vitit 2018 në dy sektorët A dhe B te:

- Fortifikimi, për të kuptuar më mirë shtrirjen, fazat dhe teknikën e ndërtimit të fortifikimit antik nëpërmjet zgjerimit të sipërfaqes së gërmimit nga perëndimi dhe lindja.
 - Banesat, për të sqaruar më mirë problemet kronologjike dhe fazat e ndërtimeve; në zonën e banesave do të bëhet thellimi i gërmimeve deri në tabanin natyror si dhe zgjerimi i tyre nga perëndimi, lindja dhe jugu.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.
 3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
 4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

6. Ngarkohet Sekretaria e Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**